FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

NEOCIL

Tableta të veshura me film – 500 mg

(Ciprofloksacinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Neocil dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Neocil
3. Si ta merrni Neocil
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Neocil
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË NEOCIL DHE PËRSE PËRDORET

Neocil përmban si lëndë aktive ciprofloksacinë. Ciprofloksacina është një antibiotik i cili bën pjesë në familjen e fluorokinoloneve. Ciprofloksacina vepron duke vrarë bakteret të cilat shkaktojnë infeksione. Vepron vetëm ndaj shtameve specifike të bakterevе.

Të rriturit
Neocil përdoret në të rritur për të trajtuar infeksionet bakteriale të mëposhtme:
- infeksione të traktit respirator;
- infeksione të veshit ose sinuseve që kanë zgjatur shumë në kohë ose që përsëriten;
- infeksione të traktit urinar;
- infeksione të traktit gjenital te meshkujt dhe femrat;
- infeksione të traktit gastro-intestinal dhe infeksione intra-abdominale;
- infeksione të lëkurës dhe indeve të buta;
- infeksione të kockave dhe kyçeve;
- parandalimin e infeksioneve të shkaktuara nga bakteri Neisseria meningitidis;
- ekspozimi ndaj antraksit inhalator.

Ciprofloksacina mund të përdoret për parandalimin dhe trajtimin e pacientëve me numër të vogël të qelizave të bardha të gjakut (neutropeni) të cilët kanë ethe që dyshohet të jetë shkaktuar nga infeksioni bakterial.
Në qoftë se keni një infeksion të rëndë ose një infeksion që është shkaktuar nga më shumë se një lloj bakteri, mund t'ju jepet trajtim shtesë me antibiotik së bashku me Neocil.

Fëmijët dhe adoleshentët
Neocil përdoret në fëmijë dhe adoleshentë, nën mbikëqyrjen mjekësore, për trajtimin e infeksioneve bakteriale të mëposhtme:
- infeksione të mushkërive dhe bronkiale në fëmijë dhe adoleshentë që vuajnë nga fibroza cistike;
- infeksione të ndërlikuara të traktit urinar, duke përfshirë infeksionet që kanë prekur veshkat (pielonefrit);
- ekspozimi ndaj antraksit inhalator.

Neocil mund të përdoret gjithashtu për të trajtuar infeksione të tjera të rënda specifike në fëmijë dhe adoleshentë kur mjeku e shikon të nevojshme.

2. PËRPARA SE TË MERRNI NEOCIL

Mos merrni Neocil:
- në qoftë se jeni alergjik ndaj lëndës aktive, kinoloneve të tjerë ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të këtij bari (të renditur në pikën 6);
- në qoftë se jeni duke marrë tizanidinë (shiko pikën 2: Marrja e barnave të tjerë).

Tregoni kujdes të veçantë me Neocil
Nuk duhet të merrni antibakterialë të grupit të fluorokinoloneve / kinoloneve, përfshirë Neocil, nëse ju ka ndodhur më parë ndonjë efekt anësor serioz pas marrjes së tyre. Në një situatë të tillë, informoni mjekun sa më parë.

Flisni me mjekun përpara se të merrni Neocil në qoftë se:
- keni patur ndonjëherë probleme të veshkave sepse mund të jetë e nevojshme që trajtimi juaj të përshtatet;
- vuani nga epilepsia ose nga ndonjë gjendje tjetër neurologjike;
- keni vuajtur nga probleme të tendineve gjatë trajtimeve të mëparshme me antibiotikë të tillë si Neocil;
- jeni diabetik sepse mund t'ju shfaqet rreziku i hipoglicemisë të shkaktuar nga ciprofloksacina;
- keni miasteni gravis (një lloj dobësie muskulore) sepse simptomat mund të përkeqësohen;
- keni probleme me zemrën; duhet të tregohet kujdes gjatë përdorimit të ciprofloksacinës;
- keni lindur ose keni histori familjare me interval QT të zgjatur (e parë në EKG, regjistrim elektrik i zemrës), keni disbalancë të kripërave në gjak (veçanërisht nivele të ulëta të kaliumit dhe magnezit në gjak), keni ritëm të zemrës shumë të ngadaltë (e quajtur 'bradikardi'), keni një zemër të dobët (pamajftueshmëri kardiake), keni patur ndonjëherë atak të zemrës (infarkt i miokardit), jeni femër ose i moshuar ose jeni duke marrë barna të tjera të cilat shkaktojnë ndryshime jonormale të EKG (shiko pikën 2 "Marrja e barnave të tjerë");
- ju ose një pjesëtar i familjes dihet që ka mungesë të glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës (G6PD), duke qenë se mund t'ju shfaqet një rrezik për anemi të shkaktuar nga ciprofloksacina;
- jeni diagnostikuar me zmadhim ose "fryrje" të një ene të madhe gjaku (aneurizëm i aortës ose aneurizëm periferik i një ene të madhe);
- ju ka ndodhur më parë episod i çarjes së aortës (çarje në murin e saj);
- jeni diagnostikuar me rrjedhje të gjakut nga valvulat e zemrës (regurgitim i valvulave të zemrës);
- keni histori familjare të aneurizmit të aortës apo çarjes së saj ose sëmundje kongjenitale të valvulave të zemrës, ose faktorë të tjerë risku apo situata predispozuese (p.sh. çrregullime të indit lidhor si sindroma Marfan, ose sindroma Ehlers–Danlos, sindroma Turner, sindroma Sjögren [sëmundje autoimune inflamatore], ose çrregullime vaskulare si arterit Takayasu, arterit me qeliza gjigande, sëmundjen Behçet, presion të lartë gjaku ose aterosklerozë të njohur, artrit reumatoid [sëmundje e kyçeve] ose endokardit [infeksion i zemrës]).

Për trajtimin e disa infeksioneve të traktit gjenital, mjeku mund t'ju përshkruajë një antibiotik tjetër së bashku me ciprofloksacinën; në qoftë se nuk ka përmirësim të simptomave pas 3 ditësh trajtim, ju lutemi të konsultoheni me mjekun.

Ndërkohë që merrni Neocil
Njoftoni mjekun menjëherë në qoftë se ju shfaqet ndonjë nga gjendjet e mëposhtme **ndërsa jeni duke marrë Neocil**. Mjeku do të vendosë në qoftë se trajtimi me Neocil duhet të ndërpritet.
- **Reaksione alergjike të rënda, që shfaqen papritur** (reaksion/shok anafilaktik, angioedemë). Që me marrjen e dozës së parë, ka një mundësi të vogël që të përjetoni një reaksion alergjik të rëndë me këto simptoma: shtrëngim në gjoks, trullosje, të përziera ose të fikët, ose marrje mendsh gjatë ngritjes në këmbë. **Në qoftë se ju ndodh kjo, ndaloni marrjen e Neocil dhe njoftoni menjëherë mjekun.**
- **Dhimbje dhe enjtje e kyçeve dhe inflamacion ose këputje e tendineve** mund të shfaqet rrallë. Risku është më i lartë në qoftë se jeni i moshuar (mbi 60 vjeç), keni marrë organ të transplantuar, keni probleme me veshkat apo jeni duke u trajtuar me kortikosteroidë. Mund të ndodhë inflamacion ose këputje e tendineve brenda 48 orëve të para të trajtimit ose deri në disa muaj pas ndërprerjes së terapisë me Neocil. Ndaloni marrjen e Neocil që në shfaqjen e parë të ndonjë dhimbjeje ose inflamacioni të tendineve (p.sh. në thembër, kyçin e dorës, bërryl, shpatull ose gju), flisni me mjekun dhe mbani në qetësi zonën e dhimbshme. Shmangni çdo sforcim të panevojshëm, sepse mund të rrisë rrezikun e këputjes së tendinit.
- Në qoftë se vuani nga **epilepsia** ose **gjendje të tjera neurologjike** të tilla si iskemia cerebrale ose insulti, mund t'ju shfaqen efekte anësore të lidhura me sistemin nervor qendror. Në qoftë se ju ndodh të keni kriza epileptike, ndaloni marrjen e Neocil dhe njoftoni menjëherë mjekun.
- Ju mund të përjetoni simptoma të dëmtimit të nervave **(neuropatisë)** të tilla si: dhimbje, djegie, therje, mpirje dhe / ose dobësi, veçanërisht në gjatësinë e këmbës, pjesën e poshtme të saj, në krahë dhe duar. Në qoftë se ndodh kjo, ndaloni marrjen e Neocil dhe njoftoni menjëherë mjekun për të parandaluar zhvillimin e një gjendjeje të parikthyeshme.
- Ju mund të përjetoni **reaksione psikiatrike** herën e parë që merrni Neocil. Simptomat mund të përkeqësohen gjatë trajtimit me Neocil në qoftë se vuani nga **depresioni** ose **psikoza**. Në raste të rralla, depresioni ose psikoza mund të përparojë drejt mendimeve për vetëvrasje, tentativë për vetëvrasje ose kryerje të vetëvrasjes. Në rast se ju ndodh kjo, njoftoni menjëherë mjekun.
- **Hipoglicemia** është raportuar më shpesh në pacientët diabetikë, më së shumti në popullatën e moshuar. Në qoftë se ndodh kjo, njoftoni menjëherë mjekun.
- **Diarrea** mund të shfaqet ndërsa jeni duke marrë antibiotikë, duke përfshirë Neocil, ose madje disa javë pasi keni ndërprerë marrjen e tyre. Në qoftë se diarreja bëhet e rëndë ose e vazhdueshme, ose vëreni që feçet përmbajnë gjak ose mukus, ndërprisni marrjen e Neocil dhe njoftoni menjëherë mjekun, sepse kjo gjendje mund të jetë e rrezikshme për jetën. Mos merrni barna të cilat ndalojnë ose ngadalësojnë lëvizjen e zorrëve.
- Në qoftë se **shikimi dëmtohet**, ose sytë tuaj preken në ndonjë mënyrë, konsultohuni menjëherë me një specialist të syve.
- Lëkura juaj bëhet më **e ndjeshme ndaj dritës së diellit ose dritës ultravjollcë (UV)** gjatë marrjes së Neocil. Shmangni ekspozimin ndaj dritës së fortë të diellit, ose ndaj dritës artificiale (UV) të tilla si solariumet.
- Njoftoni mjekun ose stafin e laboratorit që jeni duke marrë Neocil në qoftë se do ju duhet t'ju marrin **kampion gjaku ose urine.**
- Njoftoni mjekun në qoftë se vuani nga **probleme me veshkat**, sepse doza juaj mund të nevojitet të përshtatet.
- Neocil mund të shkaktojë **dëmtime të mëlçisë**. Në qoftë se vëreni çdo lloj simptome si: humbje oreksi, ikter (zverdhje e lëkurës), urinë me ngjyrë të errët, kruajtje, ose ndjeshmëri në stomak, njoftoni menjëherë mjekun.
- Neocil mund të shkaktojë një reduktim të numrit të rruazave të bardha të gjakut dhe **rezistenca juaj ndaj infeksioneve mund të zvogëlohet.** Në qoftë se ju shfaqet një infeksion me simptoma të tilla si ethe dhe përkeqësim serioz i gjendjes suaj të përgjithshme, ose ethe me simptoma lokale të infeksionit të tilla si dhimbje të fytit / faringut / gojës ose probleme urinare duhet të shkoni menjëherë te mjeku. Do t'ju kërkohet analiza e gjakut për të kontrolluar pakësimin e mundshëm të qelizave të bardha të gjakut (agranulocitozë). Është e rëndësishme të informoni mjekun në lidhje me barnat që jeni duke marrë;
- Në qoftë se ndjeni dhimbje të fortë, të papritur, në abdomen, kraharor apo shpinë, të cilat mund të jenë simptoma të aneurizmës dhe çarjes së aortës, drejtohuni menjëherë në urgjencë; rreziku mund të rritet, nëse jeni duke u trajtuar me kortikosteroidë sistemikë;
- Në qoftë se përjetoni gulçim të shpejtë e të papritur, veçanërisht kur qëndroni shtrirë në shtrat, ose vëreni ënjtje të kyçeve, këmbëve ose barkut, ose palpitacione (ndjesi të rrahjeve të shpejta ose të çrregullta të zemrës), duhet të informoni menjëherë mjekun.

Efekte anësore serioze, të zgjatura, gjymtuese dhe potencialisht të pakthyeshme
Antibakterialët e grupit të fluorokinoloneve / kinoloneve, përfshirë ciprofloksacinën, janë shoqëruar me efekte anësore shumë të rralla, por serioze, gjymtuese, disa prej të cilëve të zgjatur në kohë (kanë vazhduar muaj ose vite), ose potencialisht të pakthyeshme. Këtu përfshihen: dhimbje e tendineve, muskujve dhe kyçeve të gjymtyrëve të sipërme dhe të poshtme, vështirësi në ecje, ndjesi jonormale si ndjesi shpimi gjilpërash, therje, gudulisje, mpirje ose djegie (parestezi), çrregullime të shqisave përfshirë dëmtimin e pamjes, shijes, nuhatjes, dëgjimit, depresion, dëmtime të kujtesës, këputje e theksuar dhe çrregullime të rënda të gjumit.
Nëse ju shfaqet ndonjë nga këto efekte pas marrjes së Neocil, njoftoni menjëherë mjekun përpara se të vazhdoni trajtimin. Bashkë me të do të vendosnimbi vazhdimësinë e trajtimit, duke marrë në konsideratë edhe antibiotikë nga klasa të tjera.

Marrja e barnave të tjerë
Njoftoni mjekun ose farmacistin në qoftë se jeni duke marrë, ose keni marrë kohët e fundit, ose mund të merrni barna të tjerë.
Mos merrni Neocil njëkohësisht me tizanidinë, sepse kjo mund të shkaktojë efekte anësore të tilla si presion i ulët i gjakut dhe përgjumje (shiko pikën 2: Mos merrni Neocil).
Barnat e mëposhtëm njihen për ndërveprimin me ciprofloksacinën në trupin e njeriut. Marrja e Neocil njëkohësisht me këto barna mund të ndikojë në efektin terapeutik të këtyre barnave. Gjithashtu mund të rritet mundësia e shfaqjes së efekteve anësore.

Njoftoni mjekun në qoftë se jeni duke marrë:
- antagonistë të Vitaminës K (p.sh.: varfarinë, acenokumarol, fenprokumon ose fluindion) ose antikoagulantë oralë (për të holluar gjakun) të tjerë;
- probenecid (për gutën);
- metotreksat (për disa tipe të caktuara të kancerit, psoriazë, artrit reumatoid);
- teofilinë (për problemet me frymëmarrjen);
- tizanidinë (për spasticitetin muskulor në sklerozën multiple);
- olanzapinë (antipsikotik);
- klozapinë (antipsikotik);
- ropinirol (për sëmundjen e Parkinsonit);
- fenitoinë (për epilepsi);
- metoklopramid (për të përziera dhe të vjella);
- ciklosporinë (për patologji të lëkurës, artrit reumatoid dhe transplantin e organeve);
- barna të tjerë të cilët mund të ndryshojnë ritmin e zemrës: barna që i përkasin grupit të antiaritmikëve (p.sh. kinidinë, hidrokinidinë, disopiramid, amiodaron, sotalol, dofetilid, ibutilid), antidepresantë triciklikë, disa antimikrobikë (që i përkasin grupit të makrolideve), disa antipsikotikë;
- zolpidem (për çrregullimet e gjumit).

Neocil mund të **rrisë** nivelet në gjak të barnave të mëposhtëm:
- pentoksifilinë (për çrregullimet e qarkullimit të gjakut);
- kafeinë;
- duloksetinë (për depresion, dëmtimin e nervave nga diabeti ose mbajtjen e urinës);
- lidokainë (për patologji të zemrës ose përdorim anestetik);
- sildenafil (p.sh.: për çrregullim të ereksionit);
- agomelatinë (për depresion).

Disa barna mund të **pakësojnë** efektin e Neocil. Njoftoni mjekun në qoftë se merrni ose dëshironi të merrni:
- antiacidë;
- omeprazol;
- shtesa mineralesh;
- sukralfat;
- një lidhës polimer të fosfateve (p.sh.: sevelamer ose karbonat lantani);
- barna ose suplemente të cilët përmbajnë: kalcium, magnez, alumin ose hekur.

Në qoftë se këto preparate janë të rëndësishme, merreni Neocil rreth dy orë përpara ose jo më parë se katër orë pas marrjes së tyre.

Marrja e Neocil me ushqim ose pije
Përveç rasteve kur e merrni Neocil gjatë vakteve, mos hani ose pini çdo produkt të bulmetit (të tillë si qumështi ose kos) ose lëngje me kalcium të shtuar kur merrni tabletat, pasi ato mund të ndikojnë në përthithjen e lëndës aktive.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Në qoftë se jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë ose po planifikoni të bëheni me fëmijë ose jeni duke ushqyer fëmijën me gji, këshillohuni me mjekun ose farmacistin përpara se të merrni këtë bar.
Është e prefereushme të shmangni përdorimin e Neocil gjatë shtatzënisë.
Mos merrni Neocil gjatë ushqimit me gji të fëmijës sepse ciprofloksacina ekskretohet në qumështin e gjirit dhe mund të jetë e dëmshme për fëmijën tuaj.

Drejtimi i automjetit ose përdorimi i makinerive
Neocil mund t'ju bëjë të ndiheni më pak vigjilentë. Mund të shfaqen disa ngjarje të padëshiruara neurologjike. Prandaj, sigurohuni që e keni kuptuar se si reagon trupi juaj ndaj Neocil përpara se të drejtoni automjetin ose të përdorni makineri. Në qoftë se keni dyshime, këshillohuni me mjekun.
Informacione të rëndësishme mbi disa nga lëndët ndihmëse të Neocil
Neocil përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për tabletë, që do të thotë se praktikisht nuk përmban natrium.

3. SI TA MERRNI NEOCIL

Mjeku do t'ju shpjegojë ekzaktësisht cilën dozë, sa shpesh dhe për sa kohë do t'ju duhet të merrni Neocil. Kjo do të varet nga tipi i infeksionit që keni dhe se sa i rëndë është ai.
Njoftoni mjekun në qoftë se vuani nga probleme me veshkat sepse mund të jetë e nevojshme që doza të përshtatet.
Trajtimi zakonisht zgjat nga 5 deri në 21 ditë, por mund të zgjasë edhe më shumë në rastet e infeksioneve të rënda. Gjithmonë merreni këtë bar ekzaktësisht siç ju ka thënë mjeku.
Këshillohuni me mjekun ose farmacistin në qoftë se nuk jeni të sigurt se sa tableta duhet të merrni dhe si ta merrni Neocil.
a) Gëlltitini tabletat me sasi të madhe lëngjesh. Mos i përtypni tabletat sepse nuk kanë shije të mirë.
b) Përpiquni t'i merrni tabletat afërsisht në të njëjtën kohë të ditës çdo ditë.
c) Mund t'i merrni tabletat gjatë vaktit ushqimor ose midis vakteve. Sasia e kalciumit që është pjesë e vaktit ushqimor nuk do të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në përthithjen e lëndës aktive. Megjithatë, **mos** merrni tabletat Neocil me produkte të bulmetit si qumështi ose kos ose lëngje frutash me shtesa mineraleshë (p.sh. lëng portokalli me shtesa kalciumi).

Mos harroni se duhet të pini shumë lëngje ndërkohë që jeni duke marrë këtë bar.

Në qoftë se merrni më shumë Neocil nga sa duhet
Në qoftë se merrni më shumë se doza e përshkruar, kërkoni menjëherë ndihmën mjekësore. Në qoftë se është e mundur, merrni tabletat ose kutinë me vete që't'ja tregoni mjekut.

Në qoftë se harroni të merrni Neocil
Merrni dozën normale menjëherë sapo të kujtoheni dhe vazhdoni ta merrni siç e ka përshkruar mjeku. Megjithatë, në qoftë se është pothuajse koha për marrjen e dozës tjetër, mos e merrni dozën e harruar dhe vazhdoni si zakonisht. Sigurohuni që të përfundoni ciklin e plotë të trajtimit.

Në qoftë se ndaloni marrjen e Neocil
Është e rëndësishme që të përfundoni ciklin e plotë të trajtimit edhe në qoftë se filloni të ndiheni më mirë pas pak ditësh. Në qoftë se ndaloni marrjen e këtij bari shumë herët, infeksioni mund të mos shërohet plotësisht dhe simptomat e infeksionit të rishfaqen ose të përkeqësohen. Gjithashtu, mund të zhvillohet rezistenca ndaj antibiotikut.
Në qoftë se keni pyetje të tjera në lidhje me përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjerë, ky bar mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Më poshtë ndodhen efektet anësore serioze më të shpeshta të cilat mund t'i konstatoni vetë:
Ndaloni marrjen e Neocil dhe njoftoni menjëherë mjekun në mënyrë që të marrë parasysh trajtimin me antibiotikë të tjerë në qoftë se vëreni ndonjë nga efektet anësore serioze të mëposhtme:
Të rralla (mund të prekin deri në 1 nga 1,000 persona)
- Konvulsione (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil).

Shumë të rralla (mund të prekin deri në 1 nga 10,000 persona)
- Reaksione alergjike të rënda, të papritura, me simptoma të tilla si: shtrëngim në gjoks, trullosje, të përziera ose të fikët, ose marrje mendsh gjatë ngritjes në këmbë (reaksion/shok anafilaktik) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- Dobësi muskulare, inflamacion i tendineve i cili mund të çojë në këputjen e tyre, që prek veçanërisht tendinet e mëdha nga ana e pasme e kaviljes (tendini i Akilit) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- Rash serioz në lëkurë, kërcënues për jetën, zakonisht në formën e flluskave ose ulçerave në: gojë, fyt, hundë, sy dhe membrana të tjera mukoze, të tilla si ato gjenitale, i cili mund të përparojë deri në flluska të përhapura gjithandej ose rrjepje të lëkurës (sindroma Stevens-Johnson, nekroliza epidermale toksike).

Të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme)
- Ndjesi të pazakonta të dhimbjes, ndjesi shpimi dhe djegieje, mpirje ose dobësi muskulare në gjymtyrë (neuropati) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- Një reaksion nga bari, i cili shkakton: rash, ethe, inflamacion të organeve të brendshme, çrregullime hematologjike dhe sëmundje sistemike (DRESS Reaksion nga Barnat me Eozinofili dhe Simptoma Sistemike, AGEP Pustulozë Akute e Përgjithshme Ekzantematoze).

Efekte të tjera anësore të cilat janë vënë re gjatë trajtimit me ciprofloksacinë janë renditur më poshtë sipas shpeshtësisë së tyre:
Të zakonshme (mund të prekin deri në 1 nga 10 persona)
- nauze, diarre;
- dhimbje dhe inflamacion kyçesh në fëmijë.

Të pazakonta (mund të prekin deri në 1 nga 100 persona)
- dhimbje kyçesh në të rritur;
- superinfeksione mykotike;
- përqëndrim i lartë i eozinofileve, një lloj qelize e bardhë e gjakut;
- pakësim oreksi;
- hiperaktivitet ose axhitim;
- dhimbje koke, marrje mendsh, probleme me gjumin, ose çrregullime të shijes;
- të vjella, dhimbje abdominale, probleme me tretjen të tilla si çrregullime në stomak (patretshmëri/urth), ose shtim i gazrave;
- rritje e sasisë së disa lëndëve të caktuara në gjak (transaminazave dhe / ose bilirubinës);
- rash, të kruara ose urtikarie;
- funksion i pakët i veshkave;
- dhimbje në muskuj ose në kocka, të ndjerit jo mirë (asteni) ose ethe;
- rritje e fosfatazës alkaline në gjak (një lëndë e caktuar në gjak).

Të rralla (mund të prekin deri në 1 nga 1,000 persona)
- dhimbje muskulare, inflamacion i kyçeve, rritje e tonusit të muskujve dhe krampe;
- inflamacion i zorrës (kolit) i lidhur me përdorimin e antibiotikëve (në raste shumë të rralla mund të jetë fatal) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- ndryshime në numrin e qelizave të gjakut (leukopeni, leukocitozë, neutropeni, anemi), rritje ose ulje e trombociteve;
- reaksion alergjik, enjtje (edema), ose enjtje e shpejtë e lëkurës ose e membranave mukoze (angioedema) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- rritje e sheqerit në gjak (hiperglicemi);
- ulje e sheqerit në gjak (hipoglicemi) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- konfuzion, çorientim, ankth, ëndrra të çuditshme, depresion (që mund të çojë në mendime për vetëvrasje, tentativë për vetëvrasje, ose kryerje të vetëvrasjes) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil) ose haluçinacione;
- ndjesi shpimi apo pickimi në lëkurë, ndjeshmëri e pazakontë ndaj stimujve të shqisave, ulje e ndjeshmërisë në lëkurë, dridhje ose marramendje;
- probleme me shikimin duke përfshirë pamjen e dyfishtë (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- zhurmë në vesh, humbje e dëgjimit, dëmtim i dëgjimit;
- rrahje të shpejta të zemrës (takikardi) ;
- zgjerim i enëve të gjakut (vazodilatacion), ulje e presionit të gjakut, ose të fikët;
- marrje fryme, duke përfshirë simptomat astmatike;
- çrregullime të mëlçisë, ikter kolestatik ose hepatit;
- ndjeshmëri ndaj dritës (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- pamjaftueshmëri renale, gjak ose kristale në urinë, inflamacion i traktit urinar;
- mbajtje e lëngjeve në trup ose djersitje e shtuar;
- rritje e niveleve të enzimës amilazë në gjak.

Shumë të rralla (mund të prekin deri në 1 nga 10,000 persona)
- një lloj i veçantë i pakësimit të numrit të qelizave të kuqe të gjakut (anemia hemolitike); një rënie e rrezikshme e numrit të një lloji të qelizave të bardha të gjakut (agranulocitozë) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil); një rënie e numrit të qelizave të kuqe dhe të bardha të gjakut dhe pllakëzave të gjakut (pancitopeni) e cila mund të jetë fatale; frenim i palcës së kockës, i cili gjithashtu mund të jetë fatal;
- reaksion alergjik i quajtur sëmundja e serumit;
- çrregullime mendore (reaksione psikotike, që mund të çojnë në mendime për vetëvrasje, tentativë për vetëvrasje apo edhe në kryerjen e vetëvrasjes) (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- migrenë, çrregullim i koordinimit, ecje e paqëndrueshme (çrregullime në ecje), çrregullime të nuhatjes (çrregullime olfaktore), presion në tru (presion intrakranial dhe pseudotumor cerebri);
- çrregullime të perceptimit të ngjyrave;
- inflamacion i mureve të enëve të gjakut (vaskulit);
- pankreatit;
- vdekje e qelizave të mëlçisë (nekrozë e mëlçisë) që shumë rrallë mund të çojë në pamjaftueshmëri hepatike kërcënuese për jetën (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil);
- gjakrrjedhje të vogla si pikëza nën lëkurë (petekie); shpërthime të ndryshme puçrrash në lëkurë ose rash;
- përkeqësim i simptomave të miastenia gravis (shiko pikën 2: Tregoni kujdes të veçantë me Neocil).

Të panjohura (frekuenca nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme)
- të ndjerit shumë i ngazëllyer (mani) ose të ndjerit e optimizmit të madh ose shumë i gjallëruar (hipomania);
- ritëm i shpejtë jonormal i zemrës, ritëm i çrregullt i zemrës i rrezikshëm për jetën, ndryshime të ritmit të zemrës (të quajtura 'zgjatje e intervalit QT', e parë në EKG, aktiviteti elektrik i zemrës);
- influencë në koagulimin e gjakut (në pacientët e trajtuar me antagonistë të vitaminës K);
- sindromë e shoqëruar me dëmtim të ekskretimit të ujit dhe nivele të ulëta të natriumit (SIADH).

Raste shumë të rralla të efekteve anësore të zgjatura (deri në muaj ose vite) ose të përhershme, si: inflamacion i tendineve, këputje e tendineve, dhimbje e kyçeve, dhimbje e gjymtyrëve, vështirësi në ecje, ndjesi jonormale si ndjesi shpimi gjilpërash, therje, gudulisje, djegie, mpirje ose dhimbje (neuropati), depresion, këputje, çrregullime të gjumit, dëmtime të kujtesës, si dhe çrregullime të dëgjimit, pamjes, shijes, nuhatjes, janë shoqëruar me administrimin e antibiotikëve të grupit të kinoloneve dhe fluorokinoloneve, në disa raste pavarësisht faktorëve pre-ekzistues të riskut.

Në pacientët që marrin fluorokinolone janë raportuar raste të zmadhimit dhe dobësimit të murit të aortës ose çarje të murit të aortës (aneurizma dhe diseksione), të cilat mund të këputen dhe mund të jenë fatale, si dhe rrjedhje të gjakut nga valvulat e zemrës. Shihni gjithashtu pikën 2.

5. SI TA RUANI NEOCIL

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Neocil pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni nën temperaturën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë tabletat e veshura me film Neocil
Lënda aktive është Ciprofloksacinë klorhidrat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 581.9 mg ciprofloksacinë klorhidrat që është ekuivalent me 500 mg ciprofloksacinë bazë.

Përbërësit e tjerë janë:
Bërthama e tabletës: dioksid silici koloidal, povidon, celulozë mikrokristalore, stearat magnezi, laurilsulfat natriumi, glikolat natriumi i amidonit, kroskarmelozë natriumi.
Veshja me film: alkool polivinilik, dioksid titani, makrogol, talk.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 tableta të veshura me film.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Gusht 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.